

VENDIM
Nr. 431, datë 11.7.2018

***PËR KRIJIMIN, ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË
KOMBËTARE TË UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE***

(i ndryshuar vendimi dhe titulli i vendimit me VKM nr. 617, datë 1.11.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, dhe të nenit 6, të ligjit nr. 90, datë 27.9.2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Krijimin e *Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK)*.
2. *AKUK-ja* është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për infrastrukturën (ministri).
3. *AKUK-ja* është organ shtetëror i specializuar në fushën e ujësjellës-kanalizimeve dhe të trajtimit të ujërave të ndotura, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në këtë vendim. *AKUK-ja* mbështet teknikisht politikat e ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën, në përputhje me legjislacionin dhe politikat e përcaktuara në strategjitë sektoriale.
4. *AKUK-ja* ka stemën, logon dhe vulën e vet zyrtare. Stema përbëhet nga stema e Republikës së Shqipërisë, me shënimet: “Republika e Shqipërisë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve”, në përputhje me përcaktimet e vendimit nr. 474, datë 10.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përdorimit të stemës së Republikës, si dhe raportin e përmasave të saj”, të ndryshuar.
5. Vula e *AKUK-ja* ka formën dhe elementet e përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave për rregullat e prodhimit, të administrimit, kontrollit dhe ruajtjes së vulave zyrtare. Vula prodhohet, administrohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. *AKUK-ja* ka statusin e agjencisë kombëtare në nivel qendror, me seli në Tiranë.
7. *AKUK-ja* drejtohet nga drejtori i përgjithshëm, i cili organizon dhe drejton të gjithë veprimtarinë e kësaj agjencie dhe përgjigjet para ministrit. Drejtori i përgjithshëm mbështetet në veprimtarinë e tij nga një zëvendësdrejtor i përgjithshëm.
8. Drejtori i përgjithshëm emërohet nga ministri përgjegjës për çështjet e infrastrukturës. Zëvendësdrejtori i përgjithshëm emërohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm. Marrëdhëniet e punës së drejtorit të përgjithshëm, zëvendësdrejtorit të përgjithshëm, nëpunësve, punonjësve, që zbatojnë projekte me financim të huaj, si dhe punonjësve të tjerë, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.
9. Struktura dhe organika e *AKUK-ja* miratohet me urdhër të Kryeministrit, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. Rregullorja për metodat e brendshme të punës dhe për sjelljen e personelit të *AKUK-ja* miratohet nga ministri, me propozimin e drejtorit të përgjithshëm të agjencisë.
10. *AKUK-ja* ka si mision zbatimin e politikës specifike shtetërore në sektorin e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimin e ujërave të ndotura, sipas pikës 3 të këtij vendimi, derisa ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve të jenë të afta për të kryer këto funksione.
11. *AKUK-ja* e ushtron veprimtarinë e vet në këto fusha përgjegjësie shtetërore derisa ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve të jenë të afta për të kryer funksionet për shërbimin e furnizimit me ujë dhe të ujësjellës-kanalizimeve

dhe trajtimin e ujërave të ndotura urbane.

12. AKUK-ja, nëpërmjet autoritetit të tij ligjor e teknik, koordinon dhe monitoron të gjitha aktivitetet sektoriale të ujësjellës-kanalizimeve, trajtimin e ujërave të ndotura, në bashkëpunim me të gjitha institucionet e vendit, në nivel qendror e vendor. AKUK-ja mbështet teknikisht zbatimin e politikave dhe strategjive në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, të trajtimit të ujërave të ndotura.

13. AKUK-ja ushtron këto kompetenca:

a) Siguron mbështetjen dhe këshillimin për ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën për ndryshimin dhe përmirësimin e kuadrit ligjor e nënligjor, në lidhje me planifikimin e territorit, politikat dhe strategjitë kombëtare, në lidhje me sektorët e furnizimit me ujë dhe kanalizime.

b) Mbështet nga ana teknike ministrinë e linjës për hartimin dhe zbatimin e politikave e të programeve e strategjive në fushën e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

c) Monitoron detyrimet për përmbushjen e objektivave strategjike, afatgjatë, afatmesëm dhe afatshkurtër, në kuadër të Strategjisë Kombëtare të Ujit dhe programeve të zhvillimit të sektorit.

ç) Drejton punën në hartimin dhe kostimin e planit strategjik të ndërhyrjeve infrastrukturore dhe garanton zbatueshmërinë dhe përditësimin e vazhdueshëm të tij.

d) Përgatit planifikimin e nevojave për investime për ndërtimin/rehabilitimin/zgjerimin e sistemeve të ujësjellës-kanalizimeve, të impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura (ITUN), bazuar në programet e qeverisë dhe në masterplanet kombëtare sektoriale.

dh) Shërben si koordinues dhe asistues i institucioneve qendrore dhe i njësive të vetëqeverisjes vendore e të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve, kur kërkohet ose përcaktohet nga kuadri ligjor për nismat për investime në fushat e ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura, si dhe ofron këshillime e asistencën e saj gjatë procesit të hartimit të projekteve në këto fusha.

e) Orienton nga pikëpamja teknike e menaxheriale dhe bashkëpunon për të gjitha projektet e ujësjellës-kanalizimeve, të ITUN-eve, të financuara nga buxheti i shtetit, buxheti i bashkisë, buxheti i shoqërisë "Ujësjellës-Kanalizime" sh.a., apo institucione financiare ndërkombëtare.

ë) Bashkëpunon me njësitë e vetëqeverisjes vendore ose shoqëritë UK, si dhe jep mendim për projektet teknike të ndërhyrjeve infrastrukturore pavarësisht burimit të financimit apo autoritetit kontraktor, me qëllim garantimin dhe zbatimin e rregullave teknike të projektimit, zbatimit e shfrytëzimit dhe monitoron ecurinë e tyre.

f) Koncepton mekanizma nxitës apo shtrëngues për operatorët e shërbimeve dhe i propozon pranë strukturave politikëbërëse.

g) Projektton, ndërtën dhe administron një sistem të integruar informacioni për të garantuar saktësi dhe cilësi të të dhënave në kohë reale, për:

- i. planifikimin e investimeve që bën secila shoqëri;
- ii. projektakte dhe akte për miratimin e projekteve;
- iii. kërkesa për financime etj.

gj) Koordinon nismat për investime në fushën e ujësjellës-kanalizimeve, në bazë të rëndësisë strategjike, si dhe merr pjesë e ofron këshillime gjatë procesit të hartimit të projekteve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve. Përgatit, gjithashtu, projekte zhvillimore dhe projekte pilot, me kërkesë të bashkive, qarqeve dhe ministrive apo institucioneve të tjera të administratës publike.

h) Është institucioni përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e procedurave e të programit të monitorimit për shërbimet e furnizimit me ujë.

i) I propozon ministrisë përgjegjëse për infrastrukturën treguesit dhe kriteret që duhet të arrijë çdo ofrues shërbimi dhe kryen monitorimin e tyre, në bazë të kontratës së performancës së dakordësuar.

j) Përgatit metodologjinë për llogaritjen dhe shpërndarjen e subvencioneve, në përputhje me politikat e miratuara dhe legjislacionin në fuqi.

k) Ushtron kontrolle me karakter teknik dhe të treguesve tregtarë, në çdo subjekt që është ofrues i shërbimeve të ujësjellës-kanalizimeve dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

l) Mund të organizohet si pjesë e subjektit të kompetencave të përbashkëta (SKP), sipas vendimit nr. 302 datë 11.5.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, dhe të ushtrijë funksionet, në përputhje me këtë vendim dhe ligjin nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”.

ll) Ndërmerr nisma për rritjen e kapaciteteve të burimeve njerëzore dhe koordinon programet dhe kurikulat e trajnimit. Planifikon nevojat për trajnime të punonjësve të shoqërive të ujësjellës-kanalizimeve dhe koordinon dhe/ose administron programet e trajnimit, të financuara nga buxheti i shtetit apo institucionet financiare ndërkombëtare.

m) Siguron mbështetjen e nevojshme financiare për shoqërinë aksionare të ujësjellës-kanalizimeve, sipas planit të biznesit të miratuar, kur ky plan nuk mund të mbulohet nga të ardhurat e vetë shoqërisë.

n) Mbështet politikëbërësit për hartimin dhe zbatimin e akteve nënligjore e të procedurave për procesin e kalimit të administrimit të shërbimeve të furnizimit me ujë, kanalizime dhe trajtimin e ujërave të ndotura nga pushteti vendor në atë qendror, në rastet e mospërmbljes së detyrimeve kontraktuale, sipas kontratës së performancës, të lidhur ndërmjet palëve.

14. Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK), me hyrjen në fuqi të këtij vendimi rristrukturohet në *Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve (AKUK)*. Të gjitha të drejtat, detyrimet dhe funksionet e AKUK-ja do të vazhdojnë të ushtrohen prej tij deri në fillimin e veprimtarisë së organeve të AKUK-ja. Për nëpunësit civilë aktualë të Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve zbatohen dispozitat e përcaktuara në legjislacionin për nëpunësit civilë në rastin e mbylljes dhe të rristrukturimit të institucionit. Për punonjësit administrativë zbatohen dispozitat e Kodit të Punës.

15. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

16. Vendimi nr. 504, datë 6.7.2016, i Këshillit të Ministrave, “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Ujësjellës-Kanalizimeve”, i ndryshuar, shfuqizohet.

17. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Agjencia Kombëtare e Ujësjellës-Kanalizimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi